

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                         |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Milot Rashica, njeriu vendimtar i Kosovës në dy përballjet e fundit me Izraelin                                                                                                                                                         |
| ADRESA  | <a href="https://piranjat.al/sport/milot-rashica-njeriu-vendimtar-i-kosoves-ne-dy-perballjet-e-fundit-me-izra-i106465">https://piranjat.al/sport/milot-rashica-njeriu-vendimtar-i-kosoves-ne-dy-perballjet-e-fundit-me-izra-i106465</a> |
| BURIMI  | piranjat.al                                                                                                                                                                                                                             |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                                                                  |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 28 shtator 2026, 17:27:40 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 17:25:04 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 793ef170b49dda481d0f4f3a7b12a0314b45c7984b06f45d802db57982f7aac9 |
| TEKSTI     | a1737ac2fdef68e5734652626e6afb07501a65ea3b3bbacb4afec28f67dc3626 |
| PAMJA      | f7f1e42d9c8ce6fcbd0c55a518c7b788064ec444c33039ccec783dcba3b26039 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 8ab5d7e896e086c751f937496b2b6dc0b510754fb602b784232e3a86b85d5050                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | 18c690da73dc1a573fdd24afdc5abc524a645e4949def315e2ee13951ef2125f                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8ab5d7e896e086c751f937496b2b6dc0b510754fb602b784232e3a86b85d5050>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

SYRI LIVE



Flash:

[kërkohet dorëheqja e](#)

["Skënderbej" nga ku protestuesit](#)

[e ministres Spahiu, PD](#)

[publikimit të investigimit nga emisioni](#)

[reagon për Vlora](#)

[çështjes së ish-drejtoreshës](#)

[shkaku i shpërthimit nga](#)

[ndërtesë në Plaka nisi](#)

[deklaratës së](#)

[bashkoi partitë politike kosovare](#)

SPORT

## Milot Rashica, njeriu vendimtar i Kosovës në dy përballjet e fundit me Izraelin

Piranjat Përditësimi i fundit 28 Shtator 2026, 19:25



Milot Rashica ka qenë protagonist i dy përballjeve të fundit të Kosovës ndaj Izraelit dhe të enjten do të kërkojë ta vazhdojë historinë e tij të veçantë kundër kësaj përfaqësueseje. Kosova dhe Izraeli do të takohen sërisht, këtë herë në Debreçen të Hungarisë, në kuadër të Ligës së Kombeve B, ndërsa Rashica është një nga lojtarët që ka lënë gjurmë në dy përballjet e mëparshme.

Përballja e parë mes dy skuadrave u zhvillua më 25 mars 2023 në Tel Aviv dhe përfundoi 1-1. Rashica e luajti të gjithë ndeshjen dhe ishte i përfshirë drejtpërdrejt në golin e Kosovës.

Në minutën e 36-të, goditja e tij u devijua nga Eli Dasa dhe përfundoi në rrjetën e Izraelit, duke i dhënë Kosovës epërsinë. Edhe pse goli u regjistrua si autogol i mbrojtësit izraelit, aksioni dhe goditja e Rashicës ishin vendimtare për epërsinë e Dardanëve.

Rashica ishte protagonist edhe në përballjen e dytë, të zhvilluar më 12 nëntor 2023 në stadiumin "Fadil Vokrri". Këtë herë nuk kishte nevojë për një devijim nga kundërshtari.

Vushtriasi shënoi golin e vetëm të ndeshjes në pjesën e parë, duke i siguruar Kosovës fitoren 1-0. Rashica luajti 78 minuta në atë takim dhe, ashtu si në Tel Aviv disa muaj më parë, ishte lojtari që ndikoi drejtpërdrejt në rezultatin e përballjes.

Kështu, në dy ndeshjet e para të Kosovës ndaj Izraelit, Rashica ka qenë i përfshirë në të tre golat e shënuar nga Dardanët. Në Tel Aviv krijoi situatën nga e cila erdhi autogoli, ndërsa në Prishtinë ishte vetë realizuesi i golit vendimtar. Në të dyja rastet, paraqitja e tij pati peshë të drejtpërdrejtë në rezultatin e Kosovës.

Tashmë, gati tri vjet pas asaj fitoreje në "Fadil Vokrri", Rashica dhe Kosova do të përballen përsëri me Izraelin, por në rrethana krejtësisht të ndryshme. Këtë herë ndeshja zhvillohet në kuadër të Ligës së Kombeve dhe Izraeli do ta ketë rolin e vendasit në Debreçen.

Edhe minutazhi i Rashicës në këtë edicion të Ligës së Kombeve ka qenë i kufizuar. Në dy ndeshjet e para të Kosovës, ai ka luajtur vetëm 17 minuta, të gjitha në fitoren 1-0 ndaj Irlandës. Madje, pas hyrjes së tij në lojë në atë takim, Kosova arriti të shënonte golin që vendosi përballjen. Ndërkohë, ndaj Austrisë, Rashica nuk mori minuta.

Të enjten, mbetet të shihet nëse përzgjedhësi Franco Foda do t'i japë sërisht hapësirë Rashicës dhe nëse vushtriasi do të jetë përsëri vendimtar për Kosovën. Historia e dy përballjeve të kaluara tregon se Izraeli është një kundërshtar ndaj të cilit Rashica ka ditur të lërë gjurmë – një herë duke krijuar aksionin nga i cili erdhi goli dhe herën tjetër duke shënuar vetë.

### Artikuj te sugjeruar

SPORT 28 Shtator13:14

[Për herë të parë pas 18 vitesh, Cristiano Ronaldo në stol dhe nuk luajti për Portugalinë!](#)

Portugalia fitoi pa Cristiano Ronaldon, edhe pse ai ishte në skuadër, gjë që është mjaft e rrallë për t'u pë...

SPORT 28 Shtator08:06

[Nga dhoma e hotelit me Guardiolën, te 15 vite si drejtor i Lazios dhe aventura te Milani! Igli Tare në një rrëfim ndryshe](#)

Në vitin 2001, kur Igli Tare luante te Brescia, një kamera shqiptare ndoqi nga afër eksperiencën e tij në Serie A. Ishte një per...

SPORT 27 Shtator22:49

#### [Greqia shkakton ‘tërmet’ në Gjermani, mposht 4 herë kampionët e botës](#)

Drama pushton Hamburgun në ndeshjen e radhës së Nations League. Greqia befasoi Gjermaninë e Jurgen Klopp duke e mundur me rezultatin 1-0 ku ...

SPORT 27 Shtator21:57

#### [Ndeshja Irlandë-Izrael pa shtrëngim duarsh, kokat ulur dhe shirita të zinj](#)

Futbolli u kthye sërish në platformën përmes së cilës lojtarët e kombëtares irlandeze shprehën qëndrimet e tyre...

SPORT 27 Shtator21:00

#### [Kosova nuk ia del në Vjenë, pëson humbje nga Austria](#)

Kombëtarja e Kosovës ka pësuar disfatë në udhëtim te Austria, në kuadër të xhiros së dytë për xhiron...

SPORT 27 Shtator19:11

#### [Dush i ftohtë për Dardanët në Vjenë, Austria ndëshkon dy herë Kosovën në 45 minutat e para](#)

Ka përfunduar me një rezultat zhgënjyes pjesa e parë e përballjes mes Austrisë dhe Kosovës e vlefshme për Ligën e K...

SPORT 27 Shtator18:06

#### [VIDEO- Skandal në Superkupën argjentinase/ Ndeshja midis dy skuadrave mbyllet me përleshje midis lojtarëve](#)

Finalja e Superkupës Argjentinase mes Estudiantes dhe Rosario Central u mbyll në mënyrën më të shëmtuar të mundshme. Ro...

SPORT 27 Shtator15:37

#### [Portieri refuzon të luajë, Irlanda rregjistron një mbrojtës si 'gardian rezervë' ndaj Izraelit](#)

Mbrojtësi Jimmy Dunne (28) është emëruar si një nga dy portierët rezervë të kombëtares së Irlandës p&eu...

SPORT 27 Shtator15:26

#### ["Rasti Malago" në Itali, Ceferin: "Ndërrhyrjet e politikës e dëmtojnë besimin e UEFA-s"](#)

"A është Euro 2032 në rrezik? Nuk kam ndërmend të komentoj skenarë hipotetikë. Ende nuk janë marrë vendime. Po th...

SPORT 27 Shtator14:59

#### [Zidane bën rotacion te Franca, me gjasa Diouf dhe Da Cunha kanë një shans ndaj Belgjikës](#)

Franca përgatitet për ndeshjen e dytë në grup për Nations League... Pas fitores së ngushtë kundër Turqisë, &ldqu...

## ME TE VIZITUARAT

LIFESTYLE 28 Shtator

#### [Horoskopi/ Dashuria, financat dhe surprizat që ...](#)

Dashi Ata që janë në një lidhje nuk duhet të nxitohen për asgjë. Për gjithçka do të bëjnë mir&e...

AKTUALITET 27 Shtator

#### [Lulëzimi i çiftit Ergys dhe Dorina Verdho/ Nga ...](#)

Çifti Ergys dhe Dorina Verdho duhet të merret si “shembull” nga familjet shqiptare për mënyrën sesi kanë shumëf...

BOTA 27 Shtator

#### [Shpërthim gjatë fluturimit të avionit me pasagj...](#)

Një avion i Lufthansa-s, që po fluturonte nga Frankfurti drejt Lisbonës, u devijua të shtunën në mbrëmje, më 26 shtator,...

INVESTIGIME 26 Shtator13:10

#### [Nga burgu në arrest shtëpie/ Eduard Limaj rikthehet në përndjekje të grave!](#)

Javën e shkuar ju folëm për dramën e një zonje 40-vjeçare, nënë e dy fëmijëve, e cila përndiqej nga 5...

**video**



PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2





PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!



Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.